



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: 383 38 312 309 email: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

**OSHP: 2023/0743**

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) si dhe nenit 29 dhe 31 të Rregullores së Punës së OSHP-se, në përbërjen nga Isa Hasani-Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së OE “Studio Hapsira” Sh.P.K kundër vendimit për anulimin e procedurës së prokurimit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Hartimi dhe revidimi i projekteve” me numër të prokurimit 624-23-6523-2-2-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – “Komuna e Suharekës”, më 05/01/2024, mori këtë:

### **Vendim**

1. Refuzohet, si e pa bazuar ankesa e Operatorit Ekonomik “Studio Hapësira” Sh.P.K. me nr. 2023/0743 , e datës 29/09/2023, kundër,” Njoftim Mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues”, (AK) Komuna e Suharekës, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Hartimi dhe revidimi i projekteve” me numër të prokurimit; 624-23-6523-2-2-1.

2.Mbetët në fuqi, ”Njoftimi Mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues”, i datës 12.09.2023, i Autoritetit Kontraktues- Komuna e Suharekës, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Hartimi dhe revidimi i projekteve” me numër të prokurimit; 624-23-6523-2-2-1.

3. Konfiskohen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës ndaj e Operatorit Ekonomik “Studio Hapsira SH.P.K”, konform nenit 31 paragrafi 5 i Rregullores së Punës së OSHP-së dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

### **Arsyetim**

*- Faktet dhe rrethanat procedurale -*

Me 26.06.2023, Komuna e Suharekës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Hartimi dhe revidimi i projekteve” me numër të prokurimit 624-23-6523-2-2-1. Ndërsa me datën 12.09.2023 AK ka

publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues për dhënie të kontratës ku ka shpërblyer me kontrate GOE “Inno Group Sh.P.K & Enggroup Sh.P.K.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës për shërbim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 85,900.00 €.

Me 15.09.2023, OE “Studio Hapësira” Sh.P.K ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 19.09.2023, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 29.09.2023, OSHP ka pranuar ankesën nga OE “Studio Hapësira” Sh.P.K me nr. 743/23 lidhur me aktivitetin “Hartimi dhe revidimi i projekteve” me numër të prokurimit 624-23-6523-2-2-1.

*-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-*

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Studio Hapësira” Sh.P.K janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi i parë (I): Ankuesi pretendon se “Më datë 23.08.2023 brenda afatit ligjor të përcaktuar nga Komuna e Suharekës përmes letrës standarde për tenderuesin e suksesshëm e kemi njoftuar Komunën e Suharekës. Një dokument i kërkuar në dosje të tenderit (Taksa Komunale) është i pa arritshëm për tu nxjerrë për shkak të personelit zyrtar (Drejtor) i cili nënshkruan dokumentin është në pushim. Autoriteti Kontraktues ka injoruar shkresën nuk ka kthyer përgjigje lidhur me udhëzime në procedurave prokurimit si të veprojme apo të shtyjme afatin apo të na refuzojë afatin e dorëzimit duke injoruar shkresën tonë.”

Pretendimi i dytë (II) Ankuesi pretendon se: “Kemi dorëzuar brenda afatit të përcaktuar me datën 23.08.2023. Kemi dorëzuar Vërtetimin Tatimorë, ndërsa kemi aplikuar edhe me të njëjtën datë edhe në Komunën e Prishtinës për tu pajisur me Vërtetim të Taksave Komunale i cili ka qenë i pa mundur të nxirret për shkak se zyrtarët komunal përgjegjës për vulosjen dhe nënshkrimin e dokumentacionit kanë qenë në pushim.”

Pretendimi i tretë (III) Ankuesi pretendon se: “ Për shkak të mungesës së palëve të treta, dokumenti i taksave komunale ka qenë i pa arritshëm brenda afateve kohore të cilat i ka përcaktuar prokurimi i komunës së Suharekës, sidoqoftë edhe pse me vonesë kemi arritur të sigurojmë dokumentin. Bazuar në dokumentin që e kemi bashkangjitur shihet qartë që ne kemi bërë kërkesë për tu pajisur me dokumentin e taksave komunale brenda afatit ligjor. Dokumenti ka qenë i pa mundur të nxirret për arsye objektive, zyrtari përgjegjës komunal për lëshimin e këtyre dokumenteve me nënshkrim dhe vulë ka qenë në pushim ku edhe kemi njoftuar me shkrim zyrën e prokurimit. Bazuar në dokumentet e prezantuara , konfirmojmë që kompania jonë është e përgjegjshme.” Duke u referuar pretendimeve si më sipër “Studio Hapësira” Sh.P.K

konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 7, 24, 40, 51, 56, 59, të LPP duke propozuar që ankesa të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi mbi vendimin e AK-së dhe aktiviteti i prokurimit të kthehet në Rivlerësim.

*- Shqyrtimi dhe administrimi i provave-*

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 05/10/2023 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 743/23, ndërsa me datë 20/10/2023 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2023/0743 me rekomandimet si në vijim: “Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.”

Lidhur me pretendimet e OE “Studio Hapësira” Sh.P.K eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2023/0743 ka vlerësuar si në vijim:

Konstatimi i parë (I): “Lidhur me këtë pretendim ankimor, eksperti shqyrtues sqaron se Autoriteti Kontraktues para se të shpërblej me kontratë OE ankues “Studio Hapësira” SH.P.K me dt. 17.08.2023 i ka kërkuar OE tani ankues që t’i sjelli dokumentet Vërtetimin e ATK-së, Vërtetimin nga Gjykata Kompetente (Origjinal ose kopje e noterizuar), Vërtetim nga Komuna. OE ankues nuk ka arritur të përgjigjet brenda afatit kohor të përcaktuar nga AK dhe se i njëjti është i pa përgjegjshëm. Autoriteti Kontraktues në rastin konkret ka vepruar konform Nenit 25 paragrafi 9 i rregullores për prokurim Publik ku afati për dorëzimin e këtyre dëshmimeve është jo më shumë se pesë ditë. Andaj konsideroj se arsyetimet e OE ankues se nuk kanë mundur të pajiset me dokumente pasi që zyrtari ka qenë në pushim kjo nuk është e qëndrueshme për shkak se nëse mungon ndonjë zyrtar caktohet zëvendësimi, gjithashtu edhe koha e paraparë sipas rregullores është 5 ditë e mjaftueshme për t’i siguruar dëshmitë e kërkuara. Rrjedhimisht pretendimi i OE ankues në këtë pikë është i pa qëndrueshëm.”

Konstatimi i dytë (II): “Lidhur me pretendimin e OE ankues se ka dorëzuar Vërtetimin Tatimor, eksperti shqyrtues sqaron se Vërtetimi Tatimor mban datën 23.08.2023 dhe i njëjti është dorëzuar me dt. 23.08.2023 i cili nuk është brenda afatit të cilin e ka përcaktuar AK-ja. Po ashtu edhe për Vërtetim të Taksave komunale, eksperti shqyrtues sqaron se është i pa qëndrueshëm arsyetimi i OE ankues për faktin se 5 ditë janë të mjaftueshme që të sigurohet një dokument, dhe nëse mungon një zyrtar e zëvendëson një tjetër dhe palët mund të marrin shërbim nëpër administratë. Rrjedhimisht pretendimi i OE ankues është i pa bazuar”.

Konstatimi i tretë (III): “Ne lidhje me pretendimin ankimor të lartcekur, eksperti shqyrtues sqaron se vete OE ankues pranon që dokumenti ka qenë i pa arritshëm brenda afateve kohore, dhe arsyetimi i OE është i pa qëndrueshëm për shkak siç e theksuam në pretendimet si më lartë pala ka pasur kohën e mjaftueshme që të siguroj dëshminë brenda afatit kohor, gjithashtu arsyetimi se zyrtari përgjegjës komunal ka qenë në pushim, eksperti shqyrtues thekson se nëse një zyrtar është në pushim nuk do të thotë që një palë nuk do të mund të merr shërbim, dhe i njëjti nëse është në pushim vulën nuk e merr vete, andaj pretendimi i OE ankues është i pa qëndrueshëm.”

Në përfundim, eksperti shqyrtues arsyeshmërinë e OE për plotësimin e kërkesës së AK-së në lidhje me dëshmitë si Vërtetimin e ATK-së, Vërtetimin nga Gjykata Kompetente (Origjinal ose kopje e noterizuar), Vërtetim nga Komuna, i konsideron si të pa bazuar për faktin se nuk janë arsye që kanë mundur ta pengoj OE ankues që të pajiset me kohë me dëshmitë e kërkuar, ndërsa

arsyetimi i OE se AK nuk ka vepruar në përputhje me nenin 61 paragrafi 3 i LPP-së, eksperti shqyrtues sqaron se kjo dispozitë nuk ka të bëjë me dëshmitë e provueshmërisë së operatorëve ekonomik dhe dispozita e lartë cekur i referohet tenderëve jo normalisht të ulët. Andaj, eksperti shqyrtues e sheh ankesën e OE ankues si të pa bazuar për faktin se nuk ka respektuar afatin e dhënë nga AK-ja për sjelljen e dëshmive të provueshmërisë së OE sipas nenit 25 paragrafin 9 të Rregullores për Prokurim Publik nr. 001/2022.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK deklaron se pajtohet rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE ka deklaruar se nuk pajtohet me raportin e ekspertës shqyrtues.

*- Gjetjet e Panelit Shqyrtues-*

Bazuar në shkresat e kësaj lënde dhe qëllimin parësor të ankesës, Paneli konsideroi se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, përderisa parashtrësat e palëve dhe veprimet e tyre, përbejnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritior. Në këtë rast, Paneli Shqyrtues konstatimet e tij i bazoi kryesisht në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, të cilat mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Paneli shqyrtues vlerëson se raporti i ekspertizës i përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë panelin dhe të gjitha palët me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore. Mirëpo duhet theksuar se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Paneli Shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit.

Prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, ndonjë raport dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjykimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të LPP.

Paneli shqyrtues me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, ka administruar si prova: Raportin e Ekspertit Shqyrtues, ankesa e OE “Studio Hapësira” Sh.P.K , Njoftimin për Kontratë, i datës 26.06.2023, Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, i datës 12.09.2023, për aktivitetin e prokurimit “Hartimi dhe revidimi i projekteve” me numër të prokurimit; 624-23-6523-2-2-1.i AK-Komuna e Suharekës.

Raporti i ekspertit shqyrtues, i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive pretendimet e operatorit ekonomik ankues OE “Studio Hapësira” Sh.P.K raporti i ekspertit është bazuar tërësisht në dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit, sipas të cilit të gjitha pretendimet ankimore të OE “Studio Hapësira” Sh.P.K, janë konstatuar si të pabazuara.

Paneli shqyrtues konstaton se OE ankues, nuk ka vepruar sipas kërkesës se AK, që t’i sjelli dokumentet Vërtetimin e ATK-së, Vërtetimin nga Gjykata Kompetente (Origjinal ose kopje e

noterizuar), Vërtetim nga Komuna, dhe nuk ka arritur të përgjigjet brenda afatit kohor të përcaktuar, andaj dhe Autoriteti Kontraktues në rastin konkret ka vepruar konform Nenit 25 paragrafi 9 i Rregullores nr; 01/2022, për Prokurim Publik.

Paneli shqyrtues përfundimisht ka vendosur për të refuzuar ankesën e OE “Studio Hapësira” Sh.P.K , dhe mbetet në fuqi Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, Komuna e Suharekës, i datës 12.09.2023, për aktivitetin e prokurimit “Hartimi dhe revidimi i projekteve” me numër të prokurimit; 624-23-6523-2-2-1.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

**Isa Hasani**

*Hasani*

### **Këshillë juridike:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA SUHAREKË**
- **OE - STUDIO HAPSIRA SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: